

## Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 10

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësime të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

### Kapitulli: Kërkimi i mirësisë nga pema, guri e të ngjashme

Allahu i Madhërisëm thotë:

"A e keni parë Latën dhe Uzzën? Po Menatën, të tretën, të fundit? Vallë, për ju janë djemtë, ndërsa për Atë vajzat?! Kjo ndarje është e padrejtë. Këta janë vetëm emra që ua keni ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse Allahu nuk ju ka dërguar për ata asnjë provë. Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzimi (për rrugën e drejtë)."<sup>1</sup>

Ebu Uakid el-Lejthi (Allahu qoftë i kënaqur me të!)<sup>2</sup> përcjell se: "U nisëm për në Hunejn me Profetin (paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe ne sapo kishim braktisur kufrin. Mushrikët kishin një pemë tek e cila qëndronin dhe i varnin armët, të cilën e quanin "Dhatu Enuat". Ne kaluam pranë një peme të tillë dhe i thamë: "O i Dërguari i Allahut, na cakto edhe ne një Dhatu Enuat, siç kanë ata!" Ai tha: "Allahu Ekber! Për Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, këto janë rrugët! Keni thënë ashtu sikurse i thanë Benu Israilët Izraelitët Musait (paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Bëna edhe neve një zot, ashtu si kanë ata! Musai tha: "Ju qenkeni vërtet një popull i paditur!"<sup>3</sup> Edhe ju gjurmët e atyre që kanë kaluar para jush do të ndiqni."<sup>4</sup>

#### Dobitë e temës

- Shpjegimi i ajetit të sures Nexhm
- Përshkrimi i asaj që kërkuan sahabët e Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!) .
- Njohja me faktin se ata nuk kaluan në veprim.
- Njohja se qëllimi i tyre ishin të afroreshin tek Allahu i Madhërisëm.

<sup>1</sup> EN-NEXHM: 19-23.

<sup>2</sup> Ai është sahabi i vyer Ebu Uakid el Lejthi. Buhariu dhe të tjerë e quajnë El Harith Ibn Auf. Mori pjesë në betejën e Bedrit. Ka disa hadithe prej Profetit \ dhe vdiq në vitin 68h. shih: "Sejr Ealam el Nubela": 2/574 dhe "Tehdhib el Kemal": 34/386.

<sup>3</sup> EL-A'RÂF: 138.

<sup>4</sup> Tirmidhi: 2180, i cili ka thënë se hadithi është Hasen Sahih. Gjithashtu: Ahmedi: 5/218, nr: 21897. Nesaiunë "El Kubra": 6/346, nr: 11185.

- Njohja se në rast se ata nuk e dinin diçka të tillë, të tjerët - që janë nën pozitën e tyre - kanë më shumë mundësi të mos e dinë.
- Njohja se ata kanë mirësi dhe u është premtuar falje që nuk gjenden tek të tjerët.
- Njohja se Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) nuk i arsyetojë atë, por ua ktheu duke u thënë: "Allahu Ekber, këto janë rrugët. Edhe ju gjurmët e atyre para jush do të ndiqni!" Me këto tre gjëra ai ua bëri të madhe atë që kishin kërkuar.
- Çështja ishte e rëndë. Ai u tregoi atyre se kërkesa që bënë ishte e njëjtë me kërkesën që i drejtuan Benu Israilët Musait (paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Bëna edhe neve një zot, ashtu si kanë ata zota!<sup>5</sup>"
- Mohimi i kërkesës së tyre është domethënia e "La ilahe ilAllah", paçka se gjë e tillë nuk ishte e qartë për ata.
- Profeti u betua gjatë dhënies fetva dhe ai betohej vetëm kur e kërkonte nevoja.
- Se shirku është i madh dhe i vogël, kjo pasi ata me atë kërkesë që bënë përsëri nuk dolën nga feja.
- Thënia e sahabit: "Ne sapo kishim braktisur kufrin". Kjo do të thotë se besimtarët e hershëm nuk mund të mos e dinin ç'nënkuptonte kërkesa e tyre.
- Thënia "Allahu Ekber" kur habitemi nga diçka. Ndryshe nga ç'mendojnë disa se është e papëlqyeshme.
- Mbyllja e rrugëve të këqija që në fillim.
- Ndalimi i përngjasimit me njerëzit e xhahiljetit<sup>6</sup>
- Zemërimi gjatë mësimit.
- Rregulli i përgjithshëm, i shpalosur në thënien: Këto janë rrugët.
- Në hadith ka shenja prej shenjave të profetësisë, pasi ajo që paralajmëroi Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) ndodhi ashtu siç e paralajmëroi ai.
- Çdo qortim i Allahut për hebrenjtë dhe të krishterët në Kuranë vlen edhe për ne.
- Është e konfirmuar se adhurimet e tyre mbështeten në urdhra. Hadithi na kujton pyetjet e varrit; Pyetja: "Kush është Zoti yt" është e qartë. Ndërsa: "Kush është profeti yt?" përftohet nga tregimi lajmeve të fshehta dhe kush është feja jote? Nga thënia: Bëna dhe ne...!" deri në fund të hadithit.
- Se rruga e ithtarëve të librave të mëparshëm është e qortueshme njëllëj si rruga e hipokritëve.
- Zemra e të cilit sapo ka lënë një besim të kotë nuk garanton mospasje mbetje të atij besimi, e kjo nisur nga thënia: "Dhe ne sapo kishim braktisur kufrin."

<sup>5</sup> EL-A'RÂF: 138.

<sup>6</sup>Njerëz me tradita dhe zakone paraislame. (shënim i përkthyesit)

## Kapitulli: Kërkimi i mirësive nga pemët, gurët e të ngjashme

Domethënë: Cili është gjykimi i këtyre veprimeve? Përgjigjja: Ai që i vepron këto gjëra është mushrik.

Atëherë, kapitulli është: Kush kërkon mirësi nga pemët, gurët e të ngjashme, është mushrik (idhujtar).

Fjala "*teberreka*" është në njësinë e foljeve "*tefeuule*" dhe nënkupton kërkimin e mirësisë. Ndërsa lënda e fjalës "*berake*" është marrë nga fjala "*buruk*", ose "*birke*". Në lidhje me rastin, kur fjala buron nga "*buruk*", kur kjo lidhet me devenë, nënkupton qëndrimin në një vend të devesë. Ndërsa kur buron nga "*birke*", kjo nënkupton një vend ku grumbullohet shumë ujë dhe moshterimin e tij<sup>7</sup>. Nga sa u tha, del se "*berake*" është kur diçka e mirë është shumë e qëndrueshme dhe e përhershme. Ndaj dhe "*teberreka*" quhet kërkimi që një mirësi të jetë shumë e qëndrueshme dhe e përhershme.

Tekstet kuranore dhe ato profetike na tregojnë se begatinë e sjell Allahu. Është Allahu i Madhërishëm Ai që begaton dhe asnjë krijesë nuk mund të begatojë dikë tjetër. Allahu i Lartësuar thotë:

"I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët."<sup>8</sup>

Fjala "i lartësuar" në arabisht merr kuptimin: "Iu shtofshin të mirat Atij i Cili ia zbriti Dalluesin robit të Vet! Qofshin ato të qëndrueshme dhe të përhershme!

Ai gjithashtu thotë:

"Qoftë i lartësuar Ai, në dorën e të Cilit është pushteti suprem"<sup>9</sup> Ose: "Ne e bekuam atë dhe Is'hakun..."<sup>10</sup> Ose: "...dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem."<sup>11</sup>

Kështu, ai i cili begaton është vetëm Allahu i Madhërishëm. Nuk është e lejueshme që dikush të thotë: "E bekova diçka" apo "unë iu kam bekuar", sepse begatia, mirësia e madhe, qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e tyre është vetëm

<sup>7</sup> Shih: "*Lisan el Arab*": 10/397.

<sup>8</sup> EL-FURKÂN: 1.

<sup>9</sup> EL-MULK: 1.

<sup>10</sup> ES-SÂFFÂT: 113.

<sup>11</sup> MERJEM: 31.

në dorën e Atij që i zotëron këto gjëra e Ai është Allahu i Lartësuar. Tekstet kuranore dhe ato profetike na tregojnë se gjërat që Allahu i ka bërë të begata, mund të jenë vende apo kohë të ndryshme, por mund të jenë edhe njerëz. Dy grupet janë:

Grupi i parë:

Allahu i Madhërishëm i ka bekuar disa vende siç janë Qabeja, rrethinat e Kudsit. Allahu i Madhërishëm thotë: "**Rrethinën e së cilës e kemi bekuar...**"<sup>12</sup> Që një vend të jetë i shenjtë do të thotë që mirësia e tij të jetë e madhe, e qëndrueshme dhe e vazhdueshme, në mënyrë që të jetë nxitje për ata që ftohen të qëndrojnë në të sa më gjatë. Kjo në asnjë rrethanë nuk do të thotë që toka e atyre vendeve apo muret e tyre të preken për të arritur begati. Kjo pasi begatia që ato gëzojnë është kuptimore, prandaj begatia nuk kalon te njeriu me prekjen e tyre ose varrosjen në to. E tillë është edhe Qabeja. Ajo është e bekuar jo në vetvete, siç pretendojnë ata që thonë se vetëm duke e prekur atë, arrihet mirësia, por ajo është e tillë në aspektin kuptimor, për shkak se zemrat janë të lidhura pas saj dhe mirësinë e madhe e fitojnë ata që e vizitojnë atë, që bëjnë tavaf rreth saj dhe kryejnë në të adhurime të ndryshme. Po ashtu edhe Guri i Zi. Ai është një gur i begatë, por begatia qëndron në aspektin e bindjes, domethënë kush e prek atë si bindje dhe ndjekje të udhëzimit profetik, arrin begatinë e ndjekjes së Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!). Është e njohur thënia e Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili kur e puthi Gurin e Zi, tha: "Unë e di se ti nuk më sjell as dëm e as dobi"<sup>13</sup>. Kur Umeri e tha këtë gjë, kishte për qëllim se ai gurë nuk i sillte gjë atij që e puthte dhe as nuk e ruante nga ndonjë e keqe, por ajo që e shtyu atë ta bënte atë veprim ishte thjeshtë për ndjekje të Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!), ndaj dhe në vijim duke iu drejtuar Gurit tha: "...Sikur mos ta kisha parë të Dërguarin e Allahut të të puthte, nuk do të të kisha puthur". Ky është kuptimi i begatisë së vendeve.

Ndërsa kuptimi se disa kohë janë të bekuara, siç është muaji i Ramazanit, apo disa ditë të tjera me vlerë do të thotë se kush kryen vepra adhurimi në këto kohë dhe synon të fitojë mirësi, ai fiton mirësi aq shumë sa nuk mundet ta arrijë diçka të tillë në kohë të tjera.

Grupi i dytë:

<sup>12</sup> EL-ISRÂ: 1.

<sup>13</sup> Trensmeton Buhariu: 1597, Muslimi 1270.

Bekimi që lidhet me disa qenie njerëzore. Është bekimi dhe begatia që Allahu i Madhërishëm ka derdhur mbi disa rob të tij besimtarë, kur në krye të tyre qëndrojnë prijësit e besimtarëve profetët dhe të dërguarit. Begatia e këtyre njerëzve është pjesë e identitetit të tyre. Domethënë se trupi i tyre është i bekuar. Është Allahu i Madhërishëm Ai që e ka bërë të bekuar trupin e Ademit (paqja e Allahut qoftë mbi të!). Është Ai që e bekoi dhe e bëri të begatë trupin e Ibrahimit, Nuhit, Isait dhe të Musait (paqja e Allahut qoftë mbi ata!). Domethënë, nëse ndonjëri prej popujve të tyre do të kërkonte begati përmes trupit të tyre, nëpërmjet prekjes, marrjes së djersës, fijeve të flokut, do të ishte e lejuar. Kjo pasi Allahu i Madhërishëm e bëri të begatë trupin e tyre edhe për të tjerët. Kështu ishte edhe profeti ynë Muhamedi i biri i Abdullahut (paqja e Allahut qoftë mbi të!) trupi i tij ishte i bekuar. Ndaj dhe është transmetuar se sahabët e Profetit kërkonin begati përmes djersës së tij<sup>14</sup>, fijeve të flokut<sup>15</sup>, edhe kur merrte abdes garonin me njëri-tjetrin kush të merrte nga uji që i pikonte nga trupi<sup>16</sup>, etj. nëpërmjet gjërave të tjera rreth të cilave ka transmetime. E gjitha kjo se begatia e trupit të tyre ishte e transmetueshme. Kjo gjë është veçori e profetëve dhe e të dërguarve të Allahut të Madhërishëm. Ndërsa të tjerët përveç tyre, shokë të profetëve dhe të të dërguarve, nuk ka argumente që të gëzojnë begati të transmetueshme tek të tjerët. Edhe për më të mirët e kësaj Bashkësie Muslimane Ebu Bekrin dhe Umerin. Ekzistojnë transmetime të shumta se sahabët e Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!), tabiînët dhe "muhadrininët"<sup>17</sup> nuk kërkonin begati nga Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu. Por ndërkohë ata e kërkonin një gjë të tillë nga flokët e Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!), nga gjurmët e abdesit që linte, nga pështyma e tij, nga djersa, rrobat, etj. Nga këto transmetimi ne mësojmë se begatia e Ebu Bekrit dhe e Umerit ishte begati e punëve të tyre dhe jo e vetëve, e që mund të transmetohej tek të tjerët siç ndodhte me Profetin (paqja e Allahut qoftë mbi të!). Ndaj në një hadith të transmetuar në *Sahihun* e Buhariut gjejmë se Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë:

"Ka pemë begatia të të cilave është si begatia e muslimanit"<sup>18</sup>

Kjo tregon se çdo musliman është i bekuar. Në *sahihun* e Buhariut, gjithashtu gjejmë thënien e Usejd Ibn Hudejrit<sup>19</sup>: "Kjo nuk është begatia e parë e juaj, o

<sup>14</sup> Siç gjendet në hadithin e transmetuar nga Buhariu nga Enes Ibn Malik: 6281, Muslimi: 2331/84.

<sup>15</sup> Siç gjendet në hadithin e transmetuar nga Buhariu nga Enes Ibn Malik: 171, Muslimi: 1305.

<sup>16</sup> Transmeton Buhariu: 2731, 2732.

<sup>17</sup> Muhadrininët janë ata që kanë jetuar në kohën e Profetit, por nuk e kanë takuar atë. Shih për këtë librin e Ibn el EL-Mulkin "El Muknië, fi Ulumil Hadith": 2/508.

<sup>18</sup> Buhariu: 5444 –fjalët e hadithit janë të tij, Muslimi: 2811. Hadithin e transmeton Umeri / .

familja e Ebu Bekrit". Kjo begati, me të cilën është i përshkruar çdo musliman, me të cilën përshkruhet edhe familja e Ebu Bekrit është begatia që vjen si pasojë e veprave të mira. Kjo begati buron nga besimi, dituria, ftesa për në Islam dhe veprat e mira. Çdo musliman është i begatë, por kjo begati nuk është pjesë e qenies së tij, por vjen prej veprave të tij, nga begatia e Islamit dhe Imanit (besimit). Vjen si rezultat i bindjes së fortë në zemër, i madhërimit të Allahut të Lartësuar, ndjekjes së të Dërguarit të Allahut. Kjo begati e diturisë dhe e veprës së mirë nuk kalon tek të tjerët. Ndaj dhe kuptimi i marrjes së begatisë nga të tjerët do të thotë: Ndjekja e rrugës së tyre. Të marrësh begati nga dijetarët do të thotë të përfitosh nga dituria e tyre, e kështu me radhë. Sakaq, nuk është e lejuar që të marrim begati prej tyre nëpërmjet prekjes apo djersës së tyre, pasi brezi më i mirë i kësaj Bashkësie Muslimane -sahabët- nuk ka marrë begati të kësaj forme nga anëtarët më të mirë të kësaj bashkësie si: Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu. Kjo gjë është e padiskutueshme.

Realiteti i begatisë që kërkonin mushrikët (idhujtarët) ishte se ata kërkonin tu shtoheshin të mirat, t'i gëzonin në vazhdimësi dhe të ishin të qëndrueshme, duke iu drejtuar këtyre zotave dhe këta zota ishin të përbëre prej idhujve, pemëve, vendeve të ndryshme, siç ishin shpellat, burimet, etj. Të gjitha këto lloj kërkesash për begati ishin idhujtari. Për këtë edhe autori (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Kapitulli: Kërkimi mirësi nga pema, guri, e të ngjashme." Kjo pasi idhujtarët kërkonin mirësi nga pemët dhe gurët. Edhe në zanafillat e Fesë Islame pemët dhe gurët nga të cilat kërkohej begati ishin të shumtë.

Thënia: " e të ngjashme." domethënë të ngjashme me pemët dhe gurët, siç janë vende të ndryshme, shpella, varre, burime të caktuara, etj. rreth të cilave injorantët kanë besime të caktuara.

Ç'gjykim ka ai që i kryen këto vepra?

Përgjigja: Ai që i kryen këto vepra është *mushrik* (idhujtar), siç e thotë qartazi shejh Abdurrahman Ibn Hasen<sup>20</sup> në shpjegimin e librit: "*Fet'hul Mexhid*", në kapitullin: "Kërkimi i mirësive nga pemët, gurët e të ngjashme."

<sup>19</sup> Usejd Ibn Hudejr Ibn Simak Ibn 'Atik Ibn Imrau'- Kais Ibn Zeid Ibn Abdul Ashhel el-Ensari el-Ashhali. Prej muslimanëve të parë, nga krerët që morën pjesë në Natën e Akabes. Islamit e pranoi nga dorë e Mus'ab Ibn Umejrit. Vdiq në vitin: 20h. shih: "El Isabe": 1/83 dhe: "Tehdhib el Kemal": 3/246.

<sup>20</sup> Abdurrahman Ibn Hasen Ibn Muhamed Ibn Abdul Uehab është prej dijetarëve të shquar në fushën e Thirrjes në Islam. Është i medh'hebit Hanbeli dhe ka mbajtur postin e gjykatësit në Rijad. Vdiq në vitin 1285h. Shih librin e Zerkelanit: "El Ealam": 3/304 dhe parathënien e "Fet'hul Mexhid": f. 9.

Ata që janë marrë me shpjegimin e kësaj teme nuk e kanë thënë qartazi se në ç'loj shirku bie ai që kërkon begati nga pemët dhe gurët: shirk të madh apo të vogël. Veçse shejh Sulejmani, në librin e "Tejsir"-it, pasi shpjegon ajetin: "A e keni parë Latën dhe Uzzën?", në fund thotë: Përshtatshmëria e ajetit me temën: Nëse kërkimi i begative (nga pemët dhe gurët) është shirk i madh, atëherë është e qartë, dhe nëse është shirk i vogël, të parët tanë të mirë (selefët) përdornin për shirkun e vogël argumentet që kanë zbritur mbi shirkun e madh<sup>21</sup>.

### Shtjellimi i plotë i kësaj çështjeje

Kërkimi i begative nga pemët, gurët, varret e vende të ndryshme mund të jetë shirk i madh ose i vogël. Është shirk i madh kur kërkohet begati duke menduar se me prekjen e tyre ndërmjetësojnë tek Allahu. Nëse besojnë që këto janë mjete që të afrojnë me Allahun, kjo konsiderohet adhurim zotash krahas Allahut të Madhërishëm, pra, shirk i madh. Kështu besonin njerëzit në kohën para-islame: te pemët, gurët apo varret, duke u kërkuar begati. Ata besonin që, nëse do të qëndronin nëpër këto vende, t'i preknin ato apo të hidhnin pluhurin e tyre në kokë, atëherë ai vend ose ai që ndodhej në atë vend, ose shpirti që shërbente në atë vend, do të ndërmjetësonte tek Allahu i Madhërishëm. Ky veprim konsiderohet si adhurim i zotave të tjerë krahas Allahut të Lartësuar. Sakaq, Allahu i Lartësuar thotë:

"Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë, përveç Tij, ata thonë: "Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu"<sup>22</sup>

Ndërkohë, kërkimi i begative mund të konsiderohet shirk i vogël në rast se pluhurosjen, bashkëngjitjen e trupit me dheun, qëndrimi në një burim etj., shihen si mjete që sjellin begati dhe jo si afruese tek Allahu. Domethënë, në rastin e dytë, ato shihen vetëm si mjete për arritjen e begative, siç ndodh me atë që mban hajmali, qafore apo penj. Nëse hedh pluhurin e varrit në kokë, duke menduar se ky dhe është i bekuar dhe trupi do të bekohet – duke e menduar këtë si shkak - atëherë është shirk i vogël, sepse në këtë rast, nuk po adhurohet dikë tjetër krahas Allahut të Lartësuar, por vetëm po konsiderohet si shkak diçka që me Sheriat nuk është e tillë. Ndërsa, në rastin e parë, nëse rrokulliset në pluhur apo ngjitet me varrin, me qëllim që ato të ndërmjetësojnë për të tek Allahu, konsiderohet shirk i madh, që të përjashton nga bashkësia muslimane. Për këtë arsye, edhe shejh Sulejmani thotë se: "Nëse kërkimi i begative (nga pemët dhe gurët) është shirk i madh, atëherë argumentimi është i qartë. Nëse

<sup>21</sup> Shiko: "Tejsir el Aziz el Hamid": faqa 139, në mënyrë të përafërt.

<sup>22</sup> EZ-ZUMER: 3.

është shirk i vogël, të parët tanë të mirë (selefët) përdornin për shirkun e vogël argumentet që kanë zbritur mbi shirkun e madh.”

“A e keni parë Latën dhe Uzzën? Po Menatën, të tretën, të fundit?” - Kur pas "a"-së së pyetjes vjen shkronja "fa", mes saj dhe shkronjës fa ka një fjali e cila kuptohet nga konteksti, dhe kontesti nis që me fillimin e sures deri në këtë vend. “Latën”: - Lata ishte një gur i bardhë, i skalitur. Ai qëndronte në një dhomë në Taif. Thyerja e tij u bë vetëm pasi fisi Thekif pranoi Islamin. Për ta shembur atë, Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) dërgoi Mugira Ibn Shuben. Ai e rrëzoi, e theu dhe e dogji me zjarr. Ai qëndronte në një shtëpi, madje kishte një rojtar dhe një kujdestar<sup>23</sup>. Shkurtimisht Lata ishte një lloj guri i bardhë.

Sipas leximit të Ibn Abasit dhe disa të tjerëve nga selefët, ajeti lexohet me dyfishim të shkronjës "t". Në bazë të këtij leximi, Lata është personi që merrej me përgatitjen e miellit për pelegrinët që shkonin të vizitonin Qabenë, ose - sipas një transmetimi tjetër - shkonin të vizitonin një gur dhe ta madhëronin atë. Në një transmetim tjetër thuhet se fjala është për personin që merrej me përgatitjen e miellit për pelegrinët, i cili kur ndërroi jetë, idhujtarët filluan t'i qëndronin tek varri<sup>24</sup>. Nga kjo rezulton se Lata ishte një gur. Nëse e lexon me dyfishimin e shkronjës "t", është varr ose gur, pranë të cilit kryente adhurime dhe jepte lëmoshë përgatitësi i miellit.

El Uzza ishte një pemë, që ndodhej mes Mekës dhe Taifit. Fillimisht ishte vetëm një, pastaj u bënë tri, madje aty u ndërtua një ndërtesë. Një fallxhore shërbente aty. Kur Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) çliroi Mekën, dërgoi atje Halid Ibn Velidin. Ai i preu të tria pemët. Kur u kthye dhe i tregoi Profetit, ai i tha: "Kthehu, se nuk ke bërë gjë!", dhe ai u kthye. Kur shkoi atje, sapo e panë shërbyesit e atij vendi, ikën dhe u arratisën në mal. Më pas, ai pa një grua të zhveshur me flokë të lëshuara. Ishte fallxhorja, e cila i shërbente atij vendi të shirkut. Ajo afronte xhinët për të humbur njerëzit. Halidi e ngriti me shpatë dhe e vrau. Kur u kthye, Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) i tha: "Ajo ishte Uzza"<sup>25</sup>.

Si përfundim, El Uzza ishte emri i një peme në atë vend. Zemrat e njerëzve ishin të lidhura me atë pemë dhe me gruan që shërbente atë lloj shirkut. Nëse do të pritej pema dhe do të lihej gjallë gruaja, kjo e fundit do t'i mashtronte njerëzit përsëri, përmes gjërave që do t'ua kujtonte, t'ua tregonte apo edhe kërkesave që do t'u plotësonte me ndihmën e xhinëve. Në këtë mënyrë, rrugët e shirkut nuk do

<sup>23</sup> Shiko: "El Esnam" të Kelebiut: f. 16. Po ashtu: "Siratu el Nebeuie" të Ibn Hishamit: 5/226.

<sup>24</sup> Shih: "Ahbar el Mekke" të El Erzekij: 1/125. Fet'hul Barij: 8/612.

<sup>25</sup> Nesiu "fi el Kubra": 6/474, nr: 11547. Ebu Jeala: 2/196, nr: 902. Shih dhe: "El Esnam" të Kelebiut: f. 25. "Ahbar el Mekke" të El Erzekij: 1/127.



të ishin të prera. Ndaj dhe Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) tha: "Ajo ishte Uzza", domethënë se esenca e Uzzas ishte ajo grua, që i mashtronte njerëzit me atë lloj shirku, ndërsa pema e Uzzas ishte thjesht një pemë.

"Po Menatën, të tretën, të fundit?"<sup>26</sup> - të fundit, me kuptimin: të ulëtën, të pavlerë<sup>27</sup>. *Menata* ishte një shkëmb. U quajt e tillë për shkak se njerëzit atje thernin shumë kurbane, në shenjë madhërimi për të.<sup>28</sup> Aspekti i përshtatjes së ajetit me temën: Ato gjëra që bënë idhujtarët në ato tri vende, janë të njëjtat me ato që vepronin edhe idhujtarët e kohëve të mëvonshme te gurët, pemët, burimet, varret etj. Kush lexon pak në lidhje me çfarë vepronin idhujtarët e hershëm, do të kuptojë se Islami ishte duke përjetuar kohën e *gurbes*<sup>29</sup> para ardhjes së kësaj ftese rizgjuese, sepse njerëzit ishin të zhytur në shirk të madh. Nëse do të hedhësh shikimin në vendet përreth, ku shirku është i përhapur, do të shikosh se sa shumë është i përhapur ky fenomen, ku njerëzit kërkojnë begati nga pemët dhe gurët. Më e rëndë se kjo është konsiderimi i varreve si zota që meriton t'u drejtohesh me lutje dhe të kryesh adhurime pranë tyre.

Më pas autori përmend në këtë kapitull hadithin e Ebu Uakid el-Lejthi (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Ky hadith është i saktë dhe me rëndësi të madhe. Aty përmendet se idhujtarët kishin një pemë, rreth së cilës kishin besime të caktuara. Besimi i tyre përmblihte tri gjëra:

- E madhëronin atë.
- Qëndronin aty.
- Aty varnin armët e tyre, me shpresë të kalimit të begatisë nga pema tek armët, në mënyrë që të ishin më efikase dhe t'u sillte sa më shumë mirësi atyre që i mbanin.

Ky veprim i tyre konsiderohet shirk, sepse ata e madhëronin atë pemë dhe qëndronin aty me qëllim adhurimi. Nëse dikush qëndron në një vend për ta madhëruar, për të kërkuar begati dhe duke e konsideruar atë qëndrim si afrim tek Allahu, ka bërë shirk. Ndaj, për shkak të këtyre tri gjërave, shirku që ata bënin, ishte i madh.

Ata sahabë të Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!) që thanë: "O i Dërguari i Allahut, na cakto edhe ne një Dhatu Enuat, siç kanë ata të tyren!" ishin të sapofutur në fe. Ata e thanë një gjë të tillë duke menduar se kërkesa e tyre nuk

<sup>26</sup> EN-NEXHM: 19-23.

<sup>27</sup> Shih: "Lisan el Arab": 4/15.

<sup>28</sup> Shih: "Fet'hul Bari": 8/613.

<sup>29</sup> Gurbe këtu nënkupton ndjekësit e paktë të rrugës së saktë (shënim i përkthyesit).

përbënte shirk dhe se deviza e teuhidit nuk rrënohej nga ajo kërkesë. Për këtë, disa dijetarë kanë thënë se: është e mundur që disa njerëz me vlera dhe dituri të mos i kenë të qarta disa çështje të teuhidit, nisur nga fakti se disa sahabë, të cilët ishin njerëzit më të ditur në fushën e gjuhës (arabe), por që e pranuan Islamin pas çlirimit të Mekës, disa çështje të teuhidit i kishin të paqarta.

Thënia: "Allahu Ekber! Për Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, këto janë rrugët. Keni thënë ashtu sikurse i thanë Benu Israilët Musait (paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Bëna edhe neve një zot, ashtu si kanë ata! Musai tha: "Ju qenkeni vërtet një popull i paditur!"<sup>30</sup>

Këtë thënie të tyre, Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) e konsideroi të ngjashme me atë thënie. Është e ditur se ata – të përmendurit në ajet - adhuruan dikë tjetër përveç Allahut të Lartësuar, domethënë, adhuruan idhuj. Ndërsa këta vetëm sa kërkuan diçka, por ndërkohë Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) ua përgjasoni thënien me atë që populli i Musait i tha Musait (paqja qoftë mbi të!): "Bëna edhe neve një zot, ashtu si kanë ata!". Megjithatë, sahabët nuk e realizuan atë që kërkuan, madje kur Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) i qortoi për kërkesën që bënë, ata hoqën dorë. Nëse do ta bënë, do të kishin bërë shirk të madh. Prandaj, për sa kohë ata vetëm shprehën kërkesë dhe nuk kaluan në veprim, thënia e tyre konsiderohet shirk i vogël, pasi kërkesa e tyre përbënte një lloj varje të zemrës tek dikush tjetër përveç Allahut të Lartësuar, ndërkohë nuk e dinin se kërkesa e tyre nuk ishte e lejuar. Përndryshe, të mos mendojë dikush se ata do të donin të kundërshtonin Profetin (paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe të thyenin urdhrin e tij. Shirku qëndronte vetëm te kërkesa e tyre. Sa për të vepruar, ata nuk kaluan në veprim. Për këtë që ata thanë, dijetarët thonë se është shirk i vogël dhe jo shirk i madh. Për këtë, edhe Profeti (paqja e Allahut qoftë mbi të!) nuk i urdhëroi ata të përtërinin besimin e tyre. Këtë tregon thënia e Profetit (paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Keni thënë ashtu sikurse i thanë Benu Israilët Musait (paqja e Allahut qoftë mbi të!)". Ai ua ngjasoni thënien e tyre me një thënie tjetër.

Shejhu (Allahu e Mëshiroftë!) del në përfundimin se ata nuk dolën nga Islami. Në librin "El Mesail" ai thotë: "Shirku është i madh dhe i vogël, pasi ata me thënien e tyre nuk dolën nga Islami"<sup>31</sup>

Ajo që del në pah është fakti se veprimi i idhujtarëve, i konsideruar shirk i madh, nuk lidhej vetëm me kërkimin begati nga pema Dhatu Envat, por lidhej me faktin që ata e madhëronin atë pemë dhe qëndronin aty me qëllim adhurimi.

<sup>30</sup> EL-A'RÂF: 138.

<sup>31</sup> Shih në faqen: 125; Çështja e njëmbëdhjetë.

U tha më parë që kërkimi begati nga pemët, gurët dhe të ngjashme me to, nëse shoqërohet me besimin se ato të afrojnë tek Allahu i Lartësuar, me ngritjen e çështjes dhe kërkimin zgjidhje prej tyre, apo që në këtë mënyrë nevoja e tyre ka më shumë gjasa të zgjidhet dhe situata e tyre pas kërkimit begati të të bëhet më e mirë, këto të gjitha janë shirk i madh. Këtë vepronin edhe idhujtarët në epokën para-islame. Nga kjo rezulton se veprimi i tyre përmbledh, sikur u tha, tri gjëra:

1. Madhërimin; domethënë, madhërimin me qëllim adhurimi, e kjo është e lejueshme vetëm për Allahun e Madhërishëm. Madhërimi i tyre në këtë formë dhe besimi se ato do të ndërmjetësonin për ta është një lloj adhurimi, i cili është shirk i pastër.
2. Ata qëndronin në ato vende. Qëndrimi pranë tyre është një lloj ibadeti. Qëndrimi me qëllimin e afrimit me Allahun, me shpresë, me frikë, e dëshirë, me dashuri, të gjitha janë një lloj adhurimi.
3. Kërkimi i begatisë. Pra, në këtë rast, kur të tria këto bëhen bashkë, kemi të bëjmë me shirk të madh.

Nëse do të vëresh me kujdes çfarë bëjnë adhuruesit e varreve, iluzionistët e hershëm dhe të kohëve tona, do të vëresh se veprimet e tyre janë të njëjta me ato që bënin idhujtarët tek Lata, Uzza dhe Dhatu Envati. Ata kanë besime të llojeve të ndryshme rreth varreve, madje dhe hekurave që i rrethojnë ato. Njerëzit në vendet ku shirku është shumë i përhapur kanë besime të caktuara rreth murit që rrethon varrin apo kangjellave që e rrethojnë atë. Kur i prekin me duar, u duket sikur prekin vetë të vdekurin dhe kanë komunikuar me shpirtin e tij, me besimin se i vdekuri do të ndërmjetësojë për ta, sepse ata e madhëruan. Ky është shirku i madh ndaj Allahut të Lartësuar. Është i tillë për shkak se zemrat e tyre shpresojnë se ai do të sjellë të mira, do t'ua largojë të keqen pa Allahun e Madhëruar dhe për shkak se e mendojnë ndërmjetës për tek Allahu, ashtu si të parët, për të cilët Allahu thotë: **“Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu”<sup>32</sup>**

Ndërsa rasti i parë, i shirkut të vogël, është kur gjërat që ata prekin, i mendojnë si shkaqe. Këtë mund ta vëresh nga disa të paditur, të cilët shkojnë dhe prekin derën e Qabesë, muret apo disa kolona. Këta, nëse mendojnë se në këto kolona ka shpirtra, apo se afër tyre është varrosur dikush, apo se ka shpirtra të mirë që janë në shërbim të këtyre shtyllave, sikurse thonë, atëherë prekja e këtyre shtyllave është shirk i madh. Ndërsa për ata që i prekin duke menduar se

<sup>32</sup> EZ-ZUMER: 3.

janë të bekuara dhe se ato shkaqe mund të shërojnë, themi: Nëse i prekin duke menduar se janë shkaqe, kanë rënë në shirk të vogël. Nëse i prekin duke i varur shpresat në to, duke menduar se sjellin begati, i madhërojnë dhe qëndrojnë aty, se aty qëndrojnë edhe shpirtra, apo i konsiderojnë ndërmjetës, në këtë rast kanë rënë në shirk të madh.